EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XXVI, nr. 8441
E premte, 27 nëntor 2026
Çmimi 0. 50 €

Bashkim Jashari dekorohet me medaljen “Nderi i Forcave të Armatosura” në Shqipëri

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA KA MIRATUAR STRATEGJINË PËR MBROJTJEN E ISH-KRERËVE TË UÇK-së NË FAZËN E APELIT, E CILA ËSHTË HARTUAR ME KONTRIBUTIN E EKSPERTËVE, INSTITUCIONEVE DHE PËRFAQËSUESVE TË TË GJITHA PARTIVE PARLAMENTARE SHQIPTARE

MIRATOHET STRATEGJIA PËR MBROJTJEN E ISH-KRERËVE TË UÇK-së NË FAZËN E APELIT

FAQE 3



Ushtruesja e detyrës së kryetares së PDK-së, Vlora Çitaku, në një konferencë për medie ka bërë me dije se është përgatitur një iniciativë e re ligjore për Dhomat e Specializuara, si dhe është miratuar strategjia për mbrojtjen e çlirimtarëve në fazën e Apelit. Duke folur për përmbajtjen dhe qëllimin e kësaj iniciative, Çitaku ka theksuar se synimi është garantimi i një procesi të drejtë gjyqësor, respektimi i të drejtave themelore të njeriut dhe krijimi i mekanizmave të mbikëqyrjes institucionale, duke mos ndërhyrë në pavarësinë e gjyqësorit

KOSOVA NË SAMITIN BE - BALLKANI PERËNDIMOR KËRKON STATUSIN E VENDIT KANDIDAT

F. 3



PËRUROHET OBELISKU KUSHTUAR JAKUP KRASNIQIT NË VENDLINDJEN E TIJ NË NEGROC

F. 6



AKTUALE



KROACIA KUSHTËZON ANËTARËSIMIN E MALIT TË ZI NË BE ME ÇËSHTJEN E KUFIRIT

F. 2

MAQEDONCI NË TIRANË: KOSOVA DHE SHQIPËRIA DUHET TA THELLOJNË BASHKËPUNIMIN PËR SIGURINË E INFORMACIONIT DHE KËRCËNIMET KIBERNETIKE

F. 5

GAP: PËRMIRËSOHET TRANSPARENCA BUXHETORE NË KOSOVË, POR ENDE MUNGOJNË DOKUMENTET DHE MEKANIZMAT E KONSULTIMIT PUBLIK

F. 6


EKONOMI



GUVERNATORI ISMAILI NË BQE: FORCIMI I DIALOGUT PËR QËNDRUESHMËRINË EKONOMIKE DHE TË ARDHMEN E PAGESAVE EVROPIANE

F. 8

SPORT



MURIQI HERO I FENERBAHÇES NDAJ SHAKHTARIT, ÇMIMIN ‘LOJTARI I NDESHJES’ IA DEDIKON GRUAS

F. 11

RENOVA PUTZ
Maqedoni Xhepçisht -Tetovë Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009 +389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM PROJEKTIM SHITJE
INFO: 049-111-101, 044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · €UROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 870
044 500 878 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website, Marketing...

KROACIA KUSHTËZON ANËTARËSIMIN E MALIT TË ZI NË BE ME ÇËSHTJEN E KUFIRIT

Zagreb, 26 nëntor - Kroacia nuk do të lejojë mbylljen e kapitullit 31 në negociatat për anëtarësimin e Malit të Zi në Bashkimin Evropian (BE) pa u zgjidhur çështja e kufirit, paralajmëroi kryeministri kroat Andrej Pllenkoviq. "Mund të them lirisht: kapitulli 31 nuk do të mbyllet derisa të zgjidhet çështja e demarkimit në kufirin tokësor. Një mesazh i qartë, që nuk mund të jetë më i qartë, por edhe miqësor. Në fund të fundit, nëse ky është problem, atëherë duhet ta dëgjojmë qartë", tha Plenkoviq në Bruksel. "Nëse dëgjojmë një mesazh të qartë nga pala malazeze, 'ne nuk konsiderojmë se ka konflikt në pikën ku kufiri tokësor takohet me detin', atëherë kemi problem. Dhe në atë rast nuk mund të ulemi në të njëjtën tryezë të familjes që quhet Bashkimi Evropian. Kjo është thelbësore", theksoi kreu i qeverisë kroate.



Kapitulli 31 përfshin politikën e jashtme, të sigurisë dhe të mbrojtjes. Kroacia e bllokoi atë në vitin 2024, menjëherë pasi Kuvendi i Malit të Zi miratoi rezolutën për Jasenovacin, gjë që shkaktoi tensione mes Podgoricës dhe Zagrebit.

Presidenti i Malit të Zi, Jakov Millatoviq, rikujtoi më 25 nëntor se as Kroacia, kur u pranua në BE, nuk e kishte të zgjidhur çështjen e kufirit me Sllovenínë, fqinjën e saj. Millatoviqi shprehu gatishmërinë që, nëse nuk arrihet marrëveshje, ta dërgojë kontestin në Gjykatën Ndërkombëtare ose në arbitrazh.

Pllenkoviqi e hodhi poshtë këtë mundësi, duke thënë se Kroacia nuk beson në arbitrazh. Ai gjithashtu ua kujtoi liderëve malazezë se të dyja situatat nuk mund të krahasohen. "Raporti mes Kroacisë dhe Malit të Zi dhe raporti mes Kroacisë dhe Sllovenisë nuk është i njëjtë. Mali i Zi ishte pjesë e ish-Jugosllavisë, e cila zhvilloi agresion të armatosur ndaj territorit kroat. Prevllaka, Konavlle, shkatërrimi i Dubrovnikut, praktikisht arritja e okupimit deri në Sllano", tha Pllenkoviq. Ai i bëri thirrje Malit të Zi të arrijë marrëveshje për kufirin tokësor, me të cilën do të zgjidheshin dhe lehtësoheshin marrëdhëniet mes dy vendeve për një kohë të gjatë.

Nëse Zagrebi zyrtar mbetet në këtë qëndrim, mund të vihet në pikëpyetje synimi i qeverisë malazeze që negociatat për anëtarësim t'i përfundojë deri në fund të këtij viti, në mënyrë që Traktati i Anëtarësimit të nënshkruhet në verën e vitit 2027.

Komisioni Evropian gjithmonë e ka konsideruar këtë kalendar realist dhe të arritshëm. Megjithatë, për çdo hap në negociatat e anëtarësimit nevojitet pajtimi i të gjitha shteteve anëtare, pasi secila prej tyre ka të drejtë vetoje. As koha nuk është në favor të Malit të Zi: deri në fund të vitit kanë mbetur rreth njëzet ditë pune sipas kalendarit të BE-së.

Çfarë është kontestuese në përcaktimin e kufirit?

Kroacia kërkon që Mali i Zi të heqë dorë nga arbitrazhi për kufirin tokësor dhe të përqendrohet në kufirin detar pranë Prevllakës, në hyrje të Gjirit të Kotorrit. "Çdo vënie në pikëpyetje e kufirit tokësor, Kroacia do ta interpretojë si pretendim territorial të Malit të Zi ndaj Kroacisë. Po flas në mënyrë eksplicite, e kam fjalën për Prevllakën", paralajmëroi Pllenkoviq.

Kufiri në gadishullin e Prevllakës është kontestuar që nga shpërbërja e Jugosllavisë në vitet '90. Kontesti përfshin tri çështje: tokën, detin dhe nëntokën detare. Për Malin e Zi është thelbësore ta ruajë kontrollin mbi hyrjen në Gjirin e Kotorrit. Kroacia konsideron se gadishulli është territor kroat dhe se deti duhet të ndahet sipas së drejtës ndërkombëtare.

Që nga viti 2002 situata rregullohet me një protokoll të përkohshëm. Sipas tij, pjesa tokësore e Prevllakës dhe brezi i ngushtë detar përreth kepit të Ostrosit janë nën kontrollin kroat. Një pjesë e hapësirës detare pranë bregut të majtë të gadishullit është shpallur "det i askujt", kështu që Mali i Zi ka ruajtur kontrollin mbi detin dhe hyrjen në gji. Ky aranzhim ishte dashur të ishte i përkohshëm, por po vazhdon tashmë që 24 vjet. Komisioni i përbashkët për zgjidhjen e kontestit është mbledhur për herë të fundit në vitin 2015.

Kufiri është një nga tetë kërkesat e Kroacisë që Mali i Zi duhet t'i përmbushë para anëtarësimit në BE.

Përveç kapitullit 31, Kroacia për momentin po bllokon edhe mbylljen e përkohshme të kapitullit 14, që ka të bëjë me transportin, dhe kapitullit 15, që lidhet me energjetikën. Bllokimi i kapitullit 15 lidhet gjithashtu me kufirin, përkatësisht me kërkimet për naftë dhe gaz në një pjesë të hapësirës detare, pasi të dyja vendet ende nuk e kanë përcaktuar kufirin detar.

PE-ja MIRATON REZOLUTË PËR VUKOVARIN, KËRKOHET QASJE NË ARKIVAT E LUFTËS TË SERBISË

Strasburg, 26 nëntor - Parlamenti Evropian (PE) miratoi një rezolutë për Vukovarin, me të cilën nderohen viktimat e krimeve të kryera në këtë qytet. Me këtë rezolutë, Serbisë i bëhet thirrje që të mundësojë qasjen në arkivat përkatëse të luftës dhe t'i publikojë të gjitha informacionet e disponueshme për lokacionet e varrezave individuale dhe masive.

Rezoluta u iniciua nga eurodeputetë kroatë të grupeve të ndryshme politike në PE.

Në tekstin e rezolutës thuhet se Vukovari është një kujtesë dhe se parimi "kurrë më" nuk mund të merret si i mirëqenë. Ky parim buron nga shkatërrimet e Luftës së Dytë Botërore dhe është në thelb të projektit evropian.

Tragjedia e Vukovarit, siç thuhet më tej, zbuloi se sa e brishtë është paqja në Evropë dhe cilat janë pasojat kur ajo nuk mbrohen me kohë.

PE-ja thekson se pranimi i krimeve, respektimi i viktimave dhe përcaktimi i fatit të personave të zhdukur janë thelbësore për pajtimin e qëndrueshëm dhe për drejtësi për të gjitha viktimat e luftërave të zhvilluara pas shpërbërjes së Jugosllavisë.

Me këtë rezolutë, PE-ja dënon ashpër mohimin, minimizimin ose madhërimin e krimeve të luftës, përfshirë nderimin publik të kriminelëve të dënuar të luftës. Në veçanti, dënon nderimet që iu bënë Ratko



Mlladiqit gjatë varrimit të tij në Beograd, më 7 shtator 2026. Mlladiqi ishte dënuar me vendim të formës së prerë për gjenocid, krime kundër njerëzimit dhe krime lufte.

Rezoluta u miratua në 35-vjetorin e rënies së Vukovarit. Mbrojtja e forcave kroate në këtë qytet u thye më 18 nëntor 1991, pas 87 ditësh luftimesh të ashpra dhe shkatërrimesh.

Kontrollin mbi Vukovarin e morën Ushtria Popullore Jugosllave (JNA) e asaj kohe dhe njësitë paramilitare. Pasi hynë në qytetin pothuajse tërësisht të shkatërruar, pasoi dëbimi i popullsisë, dërgimi i të burgosurve në kampe dhe krime të rënda lufte. Ndër to ishte edhe masakra në Ovçara, ku u vranë rreth 260 persona, kryesisht të plagosur, të sëmurë dhe civilë të dërguar nga spitali i Vukovarit.

Pas publikimit të draft-rezolutës, Lëvizja Studentore në Serbi njoftoi se nuk pajtohet me përmbajtjen e tekstit. Sipas vlerësimit të kësaj lëvizjeje, dokumenti nuk kontribuon në pasqyrimin objektiv të ngjarjeve historike, as në pajtimin mes popujve të ish-Jugosllavisë.

"Temu" detyrohet t'i ndryshojë praktikat tregtare në Evropë, BE kundër uljeve të rreme dhe ofertave mashtruese

Bruksel, 26 nëntor - Platforma e njohur e blerjeve online "Temu" ka marrë përsipër të përshtatë një sërë praktikash tregtare me legjislacionin evropian për mbrojtjen e konsumatorit.

Lajmi u bë me dije të enjten nga Komisioni Evropian, pas shqyrtimit të mënyrës se si platforma ndërvepron me klientët, raporton "Reuters".

Sipas Komisionit, angazhimet e "Temu"-t lidhen me disa praktika që mund t'i mashtrojnë konsumatorët ose të ndikojnë në mënyrë të padrejtë në vendimet e tyre për blerje. Mes tyre janë zbritjet e rreme, komentet e manipuluara, mesazhet që krijojnë ndjesinë e urgjencës për të blerë dhe mungesa e informacionit të qartë.

Një nga ndryshimet e njoftuara lidhet me lojërat promocionale, si rrotullimi i rrotës për të fituar oferta dhe për të hyrë në platformë. "Temu" është angazhuar t'u japë fund këtyre mekanizmave të detyruar, si dhe mesazheve që ushtrojnë presion te përdoruesit për blerjet.

Kompania ka premtuar informacion më të qartë dhe më të qasshëm për shërbimin ndaj klientit, çmimet, pretendimet mjedisore dhe procesin e pagesës. Ajo është angazhuar edhe për ta bërë më të lehtë procesin e rimbursimit të parave.

Një zëdhënës i "Temu"-t deklaroi se kompania është e kënaqur me arritjen e marrëveshjes dhe se do të vijojë të punojë për rritjen e transparencës dhe përmirësimin e përvojës së blerjeve për konsumatorët në Evropë.



EPOKA E RE
Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

KOSOVA KA MIRATUAR STRATEGJINË PËR MBROJTJEN E ISH-KRERËVE TË UÇK-SË NË FAZËN E APELIT, E CILA ËSHTË HARTUAR ME KONTRIBUTIN E EKSPERTËVE, INSTITUCIONEVE DHE PËRFAQËSUESVE TË TË GJITHA PARTIVE PARLAMENTARE SHQIPTARE

MIRATOHET STRATEGJIA PËR MBROJTJEN E ISH-KRERËVE TË UÇK-SË NË FAZËN E APELIT

Ushtruesja e detyrës së kryetares së PDK-së, Vlora Çitaku, në një konferencë për medie ka bërë me dije se është përgatitur një iniciativë e re ligjore për Dhomat e Specializuara, si dhe është miratuar strategjia për mbrojtjen e çlirimtarëve në fazën e Apelit. Duke folur për përmbajtjen dhe qëllimin e kësaj iniciative, Çitaku ka theksuar se synimi është garantimi i një procesi të drejtë gjyqësor, respektimi i të drejtave themelore të njeriut dhe krijimi i mekanizmave të mbikëqyrjes institucionale, duke mos ndërhyrë në pavarësinë e gjyqësorit

EPOKA E RE

Mal QORRAJ



Prishtinë, 26 nëntor - Ushtruesja e detyrës së kryetares së Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Vlora Çitaku, ka bërë me dije të enjten se janë shënuar zhvillime të reja në kuadër të angazhimeve për mbrojtjen e ish-krerëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), të cilët po gjykohen në Hagë, si dhe lidhur me iniciativën e re ligjore për Dhomat e Specializuara.

Në një konferencë për medie, Çitaku ka njoftuar se tashmë është pranuar drafti i iniciativës së re ligjore për Dhomat e Specializuara, i hartuar dhe harmonizuar nga ekspertë juridikë. Ajo ka bërë me dije se këtë draft ua ka paraqitur anëtarëve të grupit strategjik në mbledhjen e mbajtur një ditë më parë. "Sot, pas disa ditësh punë intensive, kam kënaqësinë t'ju konfirmoj disa zhvillime të reja dhe tejet të rëndësishme për mbrojtjen e çlirimtarëve tanë në Hagë dhe për iniciativën e re ligjore për Dhomat e Specializuara. Jo sepse konsideroj se kemi bërë diçka të jashtëzakonshme, por sepse po përmbushim një detyrë dhe një premtim që kemi marrë publikisht para qytetarëve të Kosovës", ka deklaruar Çitaku.

Ajo ka theksuar se drafti i iniciativës së re ligjore është pranuar dy ditë më parë, ndërsa një ditë më pas u është paraqitur të gjithë anëtarëve të grupit strategjik. "E para: Para dy ditësh kam pranuar draftin e iniciativës së re ligjore për Dhomat e Specializuara, të hartuar dhe harmonizuar nga ekspertë juridikë. Dje, në mbledhjen e radhës të grupit strategjik, ua kam paraqitur këtë draft të gjithë anëtarëve të grupit", ka thënë ajo.

Duke folur për përmbajtjen dhe qëllimin e kësaj iniciative, Çitaku ka theksuar se synimi është garantimi i një procesi të drejtë gjyqësor, respektimi i të drejtave themelore të njeriut dhe krijimi i mekanizmave të mbikëqyrjes institucionale, duke mos ndërhyrë në pavarësinë e gjyqësorit. Ajo ka mohuar se iniciativa ka për qëllim shmangien apo pengimin e drejtësisë, duke theksuar se kërkesat e tyre lidhen me respektimin e standardeve ndërkombëtare dhe parimeve të një procesi të drejtë gjyqësor.

"Qëllimi i iniciativës sonë mbetet i pandryshuar: të garantojmë një proces të drejtë gjyqësor, respektimin e të drejtave themelore të njeriut dhe mekanizma të mirëfilltë të mbikëqyrjes institucionale, duke respektuar pavarësinë e gjyqësorit. Në asnjë moment - dhe kjo është shumë e rëndësishme të thuhet - nuk kemi synuar t'i ikim drejtësisë apo ta pengojmë atë", ka deklaruar Çitaku.

Ajo ka përsëritur se kërkesa e tyre është që Dhomat e Specializuara të veprojnë në përputhje me parimet mbi të cilat janë themeluar, duke garantuar respektimin e të drejtave të njeriut, barazinë e armëve dhe standardet evropiane. "Po e ripërsëris, kërkesa jonë është një dhe e pandryshueshme: që kjo gjykatë t'i respektojë parimet mbi të cilat është ndërtuar, t'i respektojë të drejtat e njeriut, barazinë e armëve dhe standardet evropiane", ka theksuar ajo.

Në konferencë, Çitaku ka njoftuar edhe për miratimin e strategjisë për mbrojtjen e ish-krerëve të UÇK-së në fazën e apelit. Sipas saj, kjo strategji është hartuar me kontributin e ekspertëve, institucioneve dhe përfaqësuesve të të gjitha partive parlamentare shqiptare në Kuvendin e Kosovës. Ajo ka vlerësuar se tashmë ekziston një dokument i përbashkët, i cili do të shërbejë si bazë për organizimin e angazhimit të shtetit të Kosovës në këtë proces.

"E dyta: Dje, në mbledhjen e grupit strategjik kemi miratuar strategjinë për mbrojtjen e çlirimtarëve në apel. Kjo strategji është hartuar me kontributin e ekspertëve, institucioneve dhe përfaqësuesve të të gjitha partive parlamentare shqiptare në Kuvendin e Kosovës. Tashmë kemi një dokument të përbashkët, mbi bazën e të cilit shteti i Kosovës do të organizojë angazhimin e tij në këtë proces", ka bërë me dije Çitaku, e cila përfaqëson Kuvendin e Kosovës në grupin punues për hartimin e strategjisë shtetërore lidhur me procedurat e Apelit para Dhomave të Specializuara në Hagë.

Sot përfundon afati për apelimin e dënimit ndaj drejtuesve të UÇK-së

Sot (e premte) përfundon afati që mbrojtja e drejtuesve të UÇK-së, Hashimit Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit e Rexhep Selimit, të njoftojë për apelimin e vendimit dënues të gjykatës së shkallës së parë Dhomave të Specializuara të Kosovës në Hagë më 16 shtator.

Tashmë avokatët e katërshes së UÇK-së kanë bërë me dije se ata do ta kundërshtojnë dënimin e ish-udhëheqësve, pasi që i kanë vlerësuar dënimet të padrejta.

Përveç tyre, edhe Prokuroria Speciale ka paralajmëruar mundësinë e apelimit, porse ende s'është bërë me dije nëse prokuroria e ka kundërshtuar vendimin e gjykatës. Në rast të apelimit, Gjykata e Apelit do t'i shqyrtojë pretendimet e palëve dhe ligjshmërinë e aktgjykimit, pa e përsëritur procesin gjyqësor në tërësi.

Sa i përket këtij procesi, nuk ka afat të caktuar se kur pritet të përfundojë, megjithatë, zëra nga njohës të fushës, kanë paralajmëruar se procesi në Apel mund të zgjasë rreth një vit.

Dënimi i ish-krerëve të UÇK-së në shtator ngjalli reagime e kundërshtime të shumta, të cilat përfunduan në protesta masive për disa ditë rresht.

Bashkim Jashari dekorohet me medaljen "Nderi i Forcave të Armatosura" në Shqipëri

Prishtinë, 26 nëntor - Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), gjenerall-ejtënant Bashkim Jashari, ka zhvilluar vizitë zyrtare në Republikën e Shqipërisë, ku është pritur me nderime ushtarake nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Shqipërisë, gjenerallejtënant Arben Kingji.

Gjatë takimit mes dy gjeneralëve është diskutuar për situatën aktuale të sigurisë në rajon dhe më gjerë si dhe për avancimin e bashkëpunimit dypalësh në fushën e mbrojtjes dhe sigurisë.

Me këtë rast, në shenjë vlerësimi për kontributin e tij të jashtëzakonshëm dhe për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet dy forcave, Jashari është dekoruar me medaljen "Nderi i Forcave të Armatosura".

Bashkëpunimi ndërmjet FSK-së dhe Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë vazhdon të thellohet, me synim adresimin e sfidave të përbashkëta të sigurisë në rajon dhe më gjerë.





KOSOVA NË SAMITIN BE – BALLKANI PERËNDIMOR KËRKON STATUSIN E VENDIT KANDIDAT

Në Samitin ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor, të mbajtur në Bruksel, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka theksuar se Kosova mbetet i vetmi vend i Ballkanit Perëndimor që ende nuk e ka statusin e vendit kandidat, ndonëse muajin e ardhshëm bëhen katër vjet nga aplikimi për anëtarësim në BE. Ai ka deklaruar se përparimi i Kosovës meriton marrjen e statusit të vendit kandidat, po ashtu edhe hapjen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Ndërkaq pikat kryesore të Deklaratës së Brukselit, të miratuar në përfundim të Samitit BE - Ballkani Perëndimor, ishin përshpejtimi i reformave në vendet e Ballkanit Perëndimor, forcimi i sundimit të ligjit, garantimi i lirisë së medias si dhe vazhdimi i luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar

Mal QORRAJ

Bruksel, 26 nëntor - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, mori pjesë në Samitin ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Ballkanit Perëndimor në Bruksel, ku liderët e BE-së dhe të vendeve të rajonit diskutuan për procesin e zgjerimit, integrimin gradual në tregun e përbashkët dhe sigurinë evropiane.

Në fjalën e tij në sesionin plenar, kryeministri theksoi se Kosova mbetet i vetmi vend i Ballkanit Perëndimor pa status kandidati, ndonëse muajin e ardhshëm mbushen katër vjet nga aplikimi për anëtarësim në BE. "Komisioni Evropian është i gatshëm dhe pret që Këshilli t'i kërkojë mendimin. Ky vendim u takon qeverive të shteteve anëtare. Ministrat e tyre mblidhen më 14 dhjetor këtu në Bruksel. Le të dalë nga ky samit një mesazh uniteti, që Këshilli t'i kërkojë më në fund Komisionit të na dërgojë pyetësorin", theksoi kryeministri. Ai tha se përparimi i Kosovës e meriton statusin e vendit kandidat dhe hapjen e negociatave për anëtarësim.

Ndër të tjera, bëri me dije se që kur indekset kryesore ndërkombëtare kanë filluar ta matin Kosovën, ajo ka përparuar më shpejt se çdo vend tjetër i rajonit në shumicën prej tyre, si dhe se Kosova është plotësisht e harmonizuar me politikën e jashtme dhe të sigurisë së përbashkët të BE-së, përfshirë sanksionet ndaj Federatës Ruse.

Kryeministri u shpreh se të gjitha reformat e Planit të Rritjes do të përmbushen, sepse ato nuk janë vetëm detyrime ndaj BE-së, por zotime ndaj qytetarëve tanë. Ai mirëpriti integrimin gradual përmes SEPA-s dhe Roam like at Home, ndërsa ngriti çështjen e bllokimit nga Serbia të pjesëmarrjes së Kosovës në Konventën për Tranzitin e Përbashkët.

Për bashkëpunimin rajonal, kryeministri kërkoi zbatimin e marrëveshjeve për lëvizshmëri të nënshkruara në kuadër të Procesit të Berlinit. "Tani është koha të tregohet nëse ndryshimi politik në Serbi është ndryshim pozitiv edhe për rajonin. Lista e Studentëve mund të fillojë duke hequr bllokadën ndaj një liste shumë më të gjatë studentësh në gjithë rajonin, të cilëve u mohohet njohja e diplomave dhe e drejta për të studiuar e për të punuar", tha ai.

Në deklarimin e tij për medie në nisje të Samitit Bashkimi Evropian - Ballkani Perëndimor, kryeministri Kurti ka theksuar se nuk po kërkojnë shpërblim, privilegj apo favor, por janë duke kërkuar vetëm që të njihet dhe pranohet përparimi i Kosovës, sa i përket avancimit demokratik, rritjes ekonomike, luftës kundër korrupsionit, sundimit të ligjit, të drejtave politike dhe lirive civile. "Dhe jemi ose të parët ose të dytët në Ballkanin Perëndimor, kur bëhet fjalë për indekset demokratike.

Njëkohësisht, më lejoni të theksoj se derisa statusi kandidat ka qenë gjithmonë tejet i rëndësishëm, tani është çështje urgjence. E dimë që ka zgjedhje pothuaj çdo muaj në vende të ndryshme të kontinentit tonë dhe gjithçka ka rëndësi, kështu që duhet ta shfrytëzojmë këtë mundësi për zgjerim të BE-së, për përfshirjen e gjashtëshes së Ballkanit Perëndimor, e posaçërisht që Republikës së Kosovës t'i jepet statusi i vendit kandidat, si çështje e meritës, pasi që qartazi e meritojmë atë. Në mënyrë që të arrijmë aty, duhet së pari që Këshilli Evropian t'i kërkojë Komisionit Evropian një opinion për Kosovën. Pra, nuk mund ta kemi përgjigjen e Komisionit Evropian pa e kërkuar atë së pari Këshilli Evropian. Dhe, shpresojmë që kjo të ndodhë muajin e ardhshëm, kur në mesin e dhjetorit, më 14 dhe 15 dhjetor, kemi takimin e radhës të madh të Këshillit Evropian", ka thënë

Kurti.
Ai i ka falënderuar të gjitha shtetet anëtare të BE-së për mbështetjen e Kosovës, kur bëhet fjalë për paqen dhe sigurinë, por gjithashtu edhe për demokracinë dhe zhvillimin. "Kemi pasur një vit të jashtëzakonshëm. Gjysma e parë e 2026-s shënoi 4.7 % të Bruto Produktit Vendor si rritje ekonomike. Dhe, tani, pas zgjedhjes së presidentes së re, kemi stabilitet të plotë institucional për vitet përpara. Çfarë na nevojitet në veçanti është zbatimi i plotë i marrëveshjeve të Procesit të Berlinit, posaçërisht marrëveshja e mobilitetit, ashtu që me njohjen e diplomave, studentët dhe profesionistët të mund të lëvizin lirshëm dhe të integrohen në tregun e punës në gjashtëshen e Ballkanit Perëndimor", është shprehur ai.
Kurti ka thënë se në lidhje me sundimin e ligjit dhe luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, duhet që Serbia të arrestojë dhe të dorëzojë kryeterroristin Milan Radoiçiq, i cili së bashku me 44 paramilitarë, shokë të tij, i dolën në pritë dhe vranë rreshterin Afrim Bunjaku, në shtator të vitit 2023. "Gjatë mandatit të ish-presidentit të Serbisë, z. Vuçiq, ai bredhte i lirë në Serbi, madje duke qenë më afër ish-presidentit Vuçiq sesa mbrojtja e tij e afërt, dhe tani shpresojmë që kjo të ndryshojë. Duhet ta mbrojmë dhe ta ruajmë shoqërinë nga kriminelët dhe, në të njëjtën kohë, duhet që BE-në ta zbatojmë si vlerë dhe jo vetëm si interes i ndërsjellë. E fundit që do të doja të përmend është që Kosova u përmbahet plotësisht parimeve evropiane, përfshirë vendimet për pranimin dhe zbatimin e të gjitha pakove të sanksioneve kundër Federatës Ruse, që nga agresioni i tyre brutal ndaj Ukrainës në shkurt të vitit 2022", ka thënë Kurti.

Von der Leyen paralajmëron rishpërndarjen e fondeve nga Plani i Rritjes

Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, ka paralajmëruar rishpërndarjen e fondeve nga Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor, në favor të vendeve që kanë shënuar përparimin më të madh në zbatimin e agjendës së reformave. Ajo e bëri këtë njoftim në përfundim të samitit BE - Ballkani Perëndimor, të mbajtur të mërkurën në Bruksel.
"Sa i përket Planit të Rritjes, ne jemi shumë të interesuar që fondet e qasshme të përdoren. Duhet ta shfrytëzojmë këtë mundësi, sepse paratë janë në dispozicion dhe duhet të investohen për të arritur rezultate", deklaroi von der Leyen në një konferencë për medie.
Ndonëse nuk i përmendi emrat e vendeve, burime të Radios Evropa e Lirë brenda Bashkimit Evropian kanë konfirmuar në mënyrë jozyrtare se fondet shtesë do t'i përfitojnë Mali i Zi, Shqipëria dhe Maqedonia e Veriut.
Bëhet fjalë për paratë që Kosova, Serbia dhe Bosnjë-Hercegovina i kanë humbur përgjithmonë për shkak të mospërmbushjes së reformave. Këto tri vende kanë humbur në mënyrë të pakthyeshme një pjesë të fondeve nga Plani i Rritjes, pasi nuk i kanë respektuar afatet për zbatimin e reformave. Ende nuk dihen shumat e sakta, përkatësisht sa para ka humbur secili prej tyre dhe sa fonde shtesë do të përfitojë secili prej tri vendeve të tjera.
Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor është paketa më ambicioze financiare e BE-së për rajonin. Ai kap vlerën e gjashtë miliardë eurove, prej të cilave dy miliardë janë grante, ndërsa katër miliardë kredi me kushte të favorshme. Qëllimi i tij është t'i afrojë vendet e rajonit me Tregun e Përbashkët të BE-së dhe ta përshpejtojë rritjen e tyre ekonomike.
Fondet ndahen dy herë në vit, vetëm pasi vendet t'i zbatojnë reformat e dakorduara në agjendat e tyre përkatëse të reformave. Të gjitha reformat kanë afate të përcaktuara kohore dhe fondet humbin përgjithmonë nëse këto afate nuk respektohen.
Liderët e vendeve të Ballkanit Perëndimor u mblodhën në Bruksel në kuadër të samitit të rregullt me Bashkimin Evropian, i cili shërbeu edhe si mundësi që institucionet evropiane ta riafirmojnë përkushtimin ndaj politikës së dyerve të hapura për vendet e rajonit, me kusht që ato të shënojnë përparim në reformat e nevojshme për afrimin me strukturat evropiane.
I vetmi që nuk mori pjesë në samitin e sivjetmë ishte kryetari i Kuvendit të Serbisë dhe ushtruesi i detyrës së presidentit, Aleksandar Çupiq. Për këtë arsye, diplomatët e BE-së konsideruan se Serbia "me shumë gjasë" nuk do të pajtohej me deklaratën përfundimtare të samitit. Deklaratën e miratojnë liderët e vendeve të BE-së, ndërsa vendet e rajonit ftohen të pajtohen me të.
Kjo është hera e dytë radhazi që Serbia nuk merr pjesë në samitin në Bruksel.
Samitin e dhjetorit të kaluar e bojkotoi presidenti i atëhershëm i Serbisë, Aleksandar Vuçiq, për shkak se në negociatat për anëtarësim nuk u hap klasteri 3. Shtetet anëtare të BE-së nuk ishin të bindura se përparimi në fushat kyçe, përfshirë sundimin e ligjit, ishte i mjaftueshëm për zhbllokimin e procesit të anëtarësimit.

Pikat kryesore të Deklaratës së Brukselit

Përshpejtimi i reformave në vendet e Ballkanit Perëndimor, forcimi i sundimit të ligjit, garantimi i lirisë së medias dhe vijimi i luftës kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar janë ndër pikat kryesore të Deklaratës së Brukselit, të miratuar në përfundim të Samitit BE - Ballkani Perëndimor, më 25 nëntor.
Në dokumentin prej shtatë faqesh, të strukturuar në 20 pika, Bashkimi Evropian rikonfirmon angazhimin e plotë për anëtarësimin e vendeve të rajonit, duke e cilësuar zgjerimin një investim gjeostrategjik për paqen, sigurinë, stabilitetin dhe prosperitetin e Evropës.
Deklarata përcakton gjithashtu prioritetet për integrimin gradual në tregun unik evropian, zbatimin e Planit të Rritjes, heqjen e tarifave shtesë të roaming-ut dhe përfundimin e Korridorit VIII, me rëndësi strategjike për Shqipërinë dhe rajonin.
Një vëmendje e veçantë i kushtohet normalizimit të marrëdhënieve ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, harmonizimit të politikës së jashtme me atë të BE-së, mbështetjes për Ukrainën dhe bashkëpunimit në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.
"Samiti i sotëm, që pason Samitin e suksesshëm të zhvilluar në Mal të Zi në qershor 2026, rikonfirmon rëndësinë strategjike në rritje të marrëdhënieve ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor, si dhe përfitimet që ato sjellin për qytetarët tanë. Situata gjeopolitike gjithnjë e më e paqëndrueshme, e karakterizuar nga lufta e agresionit të Rusisë kundër Ukrainës, konfliktet në Lindjen e Mesme dhe intensifikimi i konkurrencës globale, nënvizon nevojën për lidhje gjithnjë e më të forta ndërmjet BE-së dhe Ballkanit Perëndimor. Ne përsërisim angazhimin tonë të plotë dhe të palëkundur ndaj perspektivës së anëtarësimit të Ballkanit Perëndimor në BE. E ardhmja e Ballkanit Perëndimor është në Bashkimin tonë. Zgjerimi është një mundësi reale, e cila duhet shfrytëzuar. Ne rikonfirmojmë rëndësinë e zgjerimit si një investim gjeostrategjik në paqen, sigurinë, stabilitetin dhe prosperitetin evropian. U bëjmë thirrje të gjithë partnerëve të Ballkanit Perëndimor të përshpejtojnë reformat vendimtare dhe të besueshme, veçanërisht në fushat themelore, dhe të përmbushin angazhimet e nevojshme për të avancuar në rrugën drejt BE-së. Ne mirëpresim dinamizmin dhe përparimin e arritur nga partnerët e Ballkanit Perëndimor në rrugën drejt BE-së që prej Samitit të fundit. Përshpejtimi i procesit të anëtarësimit, i bazuar në reforma të besueshme nga partnerët, në kushte të drejta dhe rigoroze, si dhe në parimin e meritave individuale, është në interesin tonë të përbashkët. Paralelisht, dhe në përputhje me Deklaratën e Granadës, BE-ja duhet të avancojë me përgatitjet dhe reformat e saj për një Bashkim më të gjerë", thuhet në deklaratën e përbashkët, duke shtuar se përsërisin rëndësinë e angazhimit të partnerëve të Ballkanit Perëndimor për t'i respektuar vlerat dhe parimet evropiane në përputhje me të drejtën ndërkombëtare, përparësinë e demokracisë, të drejtat dhe vlerat themelore, si dhe sundimin e ligjit.
Në fund të dokumentit, Këshilli Evropian specifikon se Serbia nuk është rreshtuar me deklaratën.

MAQEDONCI NË TIRANË: KOSOVA DHE SHQIPËRIA DUHET TA THELLOJNË BASHKËPUNIMIN PËR SIGURINË E INFORMACIONIT DHE KËRCËNIMET KIBERNETIKE

Prishtinë, 26 nëntor - Ministri i Mbrojtjes, Ejup Maqedonci, mori pjesë të enjten në Tiranë në konferencën me temë "Sfidat e sigurisë së informacionit në realitetin e TIK-ut", e organizuar nga Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) i Republikës së Shqipërisë dhe Agjencia për Mbrojtjen e Informacionit të Klasifikuar (AMIK) e Republikës së Kosovës.
Gjatë fjalës së tij në këtë konferencë, ministri theksoi rëndësinë e thellimit të bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Republikës së Shqipërisë si dhe domosdoshmërinë e koordinimit ndërinstitucional dhe të përfshirjes aktive të shoqërisë civile në të dyja vendet, me qëllim që t'i adresojë sfidat që lidhen me sigurinë e informacionit dhe kërcënimet kibernetike.
Po ashtu, ministri Maqedonci tha se bashkëpunimi i ndërsjellë, shkëmbimi i përvojave dhe avancimi i kapaciteteve institucionale, në përputhje me standardet e NATO-s dhe Bashkimit Evropian, përbëjnë elemente thelbësore për forcimin e sigurisë së përbashkët dhe rritjen e qëndrueshmërisë ndaj kërcënimeve në hapësirën kibernetike.
Ministri ritheksoi përkushtimin për të bashkëpunuar vazhdimisht që të avancojë më tej kapacitetet në fushën e sigurisë së informacionit si kontribut për të garantuar mjedis të sigurt dhe të qëndrueshëm për të dyja vendet.



GAP: PËRMIRËSOHET TRANSPARENCA BUXHETORE NË KOSOVË, POR ENDE MUNGOJNË DOKUMENTET DHE MEKANIZMAT E KONSULTIMIT PUBLIK

Prishtinë, 26 nëntor - Instituti GAP ka publikuar rezultatet e Anketës së Buxhetit të Hapur për vitin 2025, sipas së cilës, Kosova ka shënuar përmirësim në të tri dimensionet e vlerësimit: transparencën buxhetore, pjesëmarrjen publike dhe mbikëqyrjen buxhetore. Sipas rezultateve të paraqitura nga ky institut, Kosova ka marrë 57 pikë nga 100 për transparencën buxhetore, 32 pikë për pjesëmarrjen publike dhe 61 pikë për mbikëqyrjen buxhetore.

Nora Latifi-Jashari nga Instituti GAP ka thënë se anketa bazohet në një pyetësor gjithëpërfshirës me më shumë se 200 pyetje dhe se vlerësimi mbështetet në dëshmi konkrete, përfshirë dokumentet buxhetore dhe legjislacionin përkatës. Ajo ka theksuar se përgjigjet i nënshtrohen gjithashtu shqyrtimit nga Partneriteti Ndërkombëtar i Buxhetit dhe një rishikues i pavarur, duke siguruar kështu një proces të standardizuar dhe të bazuar në fakte. "Anketa e Buxhetit të Hapur bazohet në një pyetësor gjithëpërfshirës prej më shumë se 200 pyetjesh dhe vlerësimi mbështetet në dëshmi konkrete, si dokumentet buxhetore dhe legjislacioni përkatës. Përgjigjet gjithashtu i nënshtrohen një vlerësimi nga Partneriteti Ndërkombëtar i Buxhetit, si dhe nga një rishikues i pavarur, duke siguruar kështu një proces të standardizuar dhe të bazuar në fakte. Për Kosovën, ky proces ka një rëndësi të veçantë, sidomos edhe për ne si GAP, pasi në vitin 2024 Instituti GAP e solli për herë të parë këtë vlerësim në vend, përmes një raporti pilot të publikuar në atë kohë. Rezultatet e atij vlerësimi të parë ishin një pikënisje e rëndësishme për të



kuptuar gjendjen e transparencës dhe llogaridhënies në financat publike të Kosovës", ka thënë ajo.

Latifi-Jashari ka rikujtuar se në vlerësimin e vitit 2024 Kosova kishte marrë 50 pikë nga 100 për transparencën buxhetore, vetëm 9 pikë për pjesëmarrjen publike dhe 59 pikë për mbikëqyrjen buxhetore. "Sot, me publikimin e vlerësimit të ri për vitin 2025, kemi mundësi të shohim se çfarë ka ndryshuar, si dhe nëse ka pasur ndryshime në metodologji. Rezultatet tregojnë përmirësim në të tria dimensionet: transparenca është rritur në 57 pikë, pjesëmarrja publike në 32 pikë, ndërsa mbikëqyrja buxhetore në 61 pikë. Këto janë zhvillime pozitive, por ende kemi dokumente buxhetore që mungojnë ose nuk publikohen me kohë. Gjithashtu, mungojnë mekanizmat e mirëfilltë për konsultimin e qytetarëve, sidomos në nivelin qendror, si dhe mbetet e nevojshme forcimi i mbikëqyrjes institucionale të zbatimit të buxhetit", ka deklaruar Latifi-Jashari.

Ndërkaq, Rrona Zhuri nga Instituti GAP, gjatë prezantimit të raportit, ka shpjeguar se Anketa e Buxhetit të Hapur është një vlerësim i pavarur global, i cili mat transparencën, gjithëpërfshirjen dhe mbikëqyrjen e proceseve buxhetore. Ajo ka bërë me dije se në vitin 2025 anketa është realizuar në 82 vende të botës, duke shqyrtuar dokumentet dhe praktikat buxhetore të publikuara gjatë vitit 2024. Sipas Zhurit, pyetësori përmban gjithsej 218 pyetje, prej të cilave 145 vlerësohen me pikë, ndërsa 73 të tjera shërbejnë për mbledhjen e informacioneve plotësuese. Ajo ka shtuar se vlerësimi ndahet në tre komponentë kryesorë: transparencën buxhetore, pjesëmarrjen publike dhe mbikëqyrjen buxhetore.

PËRUROHET OBELISKU KUSHTUAR JAKUP KRASNIQIT NË VENDLINDJEN E TIJ NË NEGROC

Drenas, 26 nëntor - Në hyrje të fshatit Negroc të Drenasit është përuruar të enjten obelisku kushtuar Jakup Krasniqit, ish-zëdhënësit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK).

Në kuadër të ceremonisë është bërë edhe zbulimi i mbishkrimit me tri shkronjat "UÇK", të vendosura në pjesën e sipërme të obeliskut.

Në objektin përkujtimor janë vendosur edhe fotografi të Jakup Krasniqit dhe komandantit legjendar të UÇK-së, Adem Jashari, ndërsa në pjesën qendrore të tij shkruhet: "Mirë se vini në Negroc, fshatin e Jakup Krasniqit".

Ish-deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Ferat Shala, ka thënë se ngritja e obeliskut në hyrje të fshatit Negroc, në nderim të Jakup Krasniqit dhe UÇK-së, përfaqëson një akt mirënjohjeje ndaj historisë dhe kontributit për lirinë e Kosovës.

Gjatë ceremonisë së përurimit të obeliskut dhe tri shkronjave të UÇK-së, Shala ka thënë se Negoci është një prej vendeve ku historia nuk lexohet vetëm në libra, por





përjetohet përmes kujtesës dhe ngjarjeve që kanë ndodhur aty. Ai ka theksuar se ura në hyrje të fshatit simbolizon lidhjen mes dy brezave, atij që e bëri lirinë dhe brezit që duhet ta ruajë atë.

Altin Krasniqi, djali i ish-kryetarit të Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, ka falënderuar bashkëfshatarët dhe të gjithë kontribuuesit për ngritjen e obeliskut në nderim të babait të tij dhe tri shkronjave të UÇK-së.

Në fjalimin e tij gjatë ceremonisë së përurimit, Altin Krasniqi ka thënë se obelisku do të mbetet simbol i përhershëm i respektit, mirënjohjes dhe kujtesës. Ai ka falënderuar në veçanti komisionin e fshatit për iniciativën dhe angazhimin, si dhe kryetarin e fshatit, Gjon Krasniqi, për kontributin në realizimin e kësaj vepre.

Në emër të familjes ai ka shprehur mirënjohje për mbështetjen dhe respektin e vazhdueshëm që, sipas tij, u është dëshmuar familjarëve të Jakup Krasniqit.

Përurimi i obeliskut vjen si një nderim për figurën e Krasniqit, i cili aktualisht ndodhet në paraburgim në Hagë, ku po gjykohet nga Dhomat e Specializuara të Kosovës.

Krasniqi kishte qëndruar për katër ditë në Kosovë, pasi Trupi Gjykues i Dhomave të Specializuara kishte miratuar kërkesën për vizitë humanitare. Ai kishte arritur në Kosovë më 18 nëntor, ndërsa pas përfundimit të vizitës ishte kthyer në Hagë.

Dhomat e Specializuara kishin bërë me dije se kjo ishte vizita e 15 e një personi të paraburgosur në Kosovë, e urdhëruar nga gjykatësit për arsye humanitare dhe e organizuar nga vetë gjykata.

"Jakup Krasniqi u kthye sot në Hagë pas vizitës së urdhëruar nga Trupi Gjykues për arsye humanitare bindëse", thuhej në njoftimin e Dhomave të Specializuara.

Gjatë qëndrimit në Kosovë, Krasniqi kishte qëndruar pranë familjes së tij në Prishtinë, ndërsa netët i kishte kaluar në objektin e EULEX-it në Fushë-Kosovë. Vizita ishte zhvilluar nën masa të veçanta sigurie.

Arrestohen tre persona të dyshuar për krim të organizuar, sekuestrohet pasuri mbi një milion euro

Prishtinë, 26 nëntor - Në bazë të urdhrit të lëshuar nga Gjykata Themelore në Prishtinë dhe nën udhëheqjen e Prokurorisë Speciale të Kosovës, hetuesit nga Policia e Kosovës, përkatësisht nga Drejtoria për Hetimin e Krimeve Kibernetike, kanë zhvilluar një operacion policor, të mbështetur edhe nga njësitë e tjera hetuese, Njësitë Speciale (FIT) dhe AKI-ja, në Prishtinë dhe Fushë-Kosovë.

Ky aksion është realizuar në katër lokacione të ndryshme, ku si rezultat janë arrestuar në flagrancë tre persona të dyshuar për përfshirje në vepra penale: "Pjesëmarrja ose organizimi i grupit kriminal të organizuar", "Mashtrimi" dhe "Shpëlarja e parave".

Gjatë realizimit të urdhër-kontrollit në këto lokacione është gjetur dhe sekuestruar sasi e konsiderueshme e provave materiale dhe pasurive të specifikuara duke përfshirë: 19 vetura; 1 motoçikletë; 6 telefona; 5 kompjuterë; 6 USB; 4,095.00 euro para të gatshme; 11.28 gramë substancë e dyshuar narkotike; Dokumente të ndryshme relevante për rastin.

Nga hetimet e deritanishme ekziston dyshimi i bazuar se tre personat e arrestuar, përmes sistemeve kompjuterike, komunikimeve elektronike dhe telefonike, kanë kontaktuar persona të ndryshëm, kryesisht shtetas të huaj, të cilët i kanë vënë në lajthitje dhe i kanë nxitur të investojnë në platforma të rreme investimi, duke i shtyrë të ndërmarrin veprime në dëm të pasurisë së tyre.



Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me Policinë e Kosovës, do ta vazhdojë ndërmarrjen e veprimeve hetimore me qëllim të zbardhjes së plotë të rastit, në përputhje me procedurat ligjore në fuqi dhe praktikat ndërkombëtare.

MBI 2 000 RASTE TË DHUNËS NË FAMILJE DHE TETË GRA TË VRARA NË KOSOVË GJATË VITIT 2026



PRISHTINË, 26 NËNTOR - Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave, që u shënua më 25 nëntor, e gjeti Kosovën me shifrën më të lartë të regjistruar të grave të vrara brenda një viti në vitet e fundit dhe me mbi 2 000 raste të raportuara të dhunës në familje.

Deri në fund të tetorit tetë gra janë vrarë në Kosovë nga partnerët dhe ish-partnerët e tyre - shifra më e lartë e regjistruar brenda një viti që nga viti 2010.

Edhe nëse krahasohet me vitin paraprak, shifra është shumë e lartë, pasi më 2025, sipas të dhënave zyrtare, ishte regjistruar një grua e vrarë si pasojë e dhunës në familje.

Shifra të larta janë regjistruar edhe sa iu përket rasteve të raportuara në Polici të Kosovës për dhunën në familje. Në periudhën janar-shtator të këtij viti 2 052 raste të dhunës në familje janë raportuar tek autoritetet dhe 1 626 viktima ishin të gjinisë femërore.

Ndërkaq, gjatë gjithë vitit të kaluar ishin raportuar 2 815 raste të dhunës në familje kur, po ashtu, shumica e viktimave i takonin gjinisë femërore.

Grupmosha më e prekur nga dhuna në familje gjatë këtij viti, sipas të dhënave, është ajo 20-30 vjeç - me 498 viktima, pasuar nga 30-40 vjeç me 494 viktima të dhunës në familje. Edhe vitin paraprak, nga këto dy grupmosha ishin regjistruar më së shumti viktima të dhunës në familje.

Ndërkaq, kryesit e dhunës në familje, sipas të dhënave deri në shtator të këtij viti, kryesisht i përkisnin grupmoshës 30-40 vjeç, përkatësisht 635.

Aktivistët për të drejtat e njeriut vazhdimisht ngrenë zërin për të drejtat e grave dhe kërkojnë që femicidi të trajtohet si urgjencë kombëtare.

Në Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave në Prishtinë është mbajtur edhe një protestë e organizuar nga Rrjeti i Grave të Kosovës, ku një ndër kërkesat është që të bëhen ndryshime në Kodin Penal dhe femicidi të përkufizohet si vepër e veçantë "duke njohur motivin gjinor dhe kontekstin e dhunës që mund t'i paraprijë vrasjes së një gruaje".

Megjithatë, protesta e një dite më parë është një në mesin e disa protestave të organizuara ku aktivistët dhe protestuesit kanë kërkuar përgjegjësi dhe veprim institucional për vrasjen e grave.

Protestat u nxitën pas vrasjes së 49-vjeçares Arlinda Zekaj, e cila më 25 tetor dyshohet se u vra nga ish-kunati, disa minuta pasi ishte kthyer nga policia pasi kishte denoncuar bashkëshortin - prej të cilit ishte ndarë - për dhunë në familje.

Rasti i Zekajt nxiti reagime të shumta për faktin se ajo kishte kërkuar mbrojtje nga institucionet duke paralajmëruar se jeta e saj ishte në rrezik.

Ndaj saj autoritetet kishin lëshuar edhe urdhër mbrojtës që, ndër të tjera, parashihte që bashkëshorti i saj të mos i afrohej në një distancë prej dy metrash brenda shtëpisë së përbashkët dhe 20 metra në ambiente të tjera.

Tre ditë para vrasjes ajo i ishte ankuar kryeprokurores së Pejës - tashmë të pezulluar nga puna pas këtij rasti - për moszbatimin e vendimit gjyqësor.

Sipas të dhënave të një databaze të Ministrisë së Drejtësisë, në Pejë gjatë këtij viti figuron vetëm se vetëm një urdhër për mbrojtje të përkohshme emergjente është lëshuar nga institucionet. Në nivel vendi, Mitrovica prin me numrin më të lartë të urdhrave të tillë të lëshuar, përkatësisht 72, për periudhën janar-shtator.

Edhe gjatë gjithë vitit paraprak më së shumti urdhra për mbrojtje emergjente ishin lëshuar në rajonin e Mitrovicës, përkatësisht 61.

Shteti ka edhe mekanizma të tjerë për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve, siç është ofrimi i strehimit të përkohshëm të tyre.

Në denoncimin e fundit në polici, pak para se të vritej, autoritetet e kishin pyetur nëse dëshironin ta dërgonin në strehimore, por Zekaj kishte refuzuar, duke këmbëngulur të kthehej në shtëpi, ku gjendeshin edhe familjarët e bashkëshortit të saj. Ajo kishte pranuar se nuk ndihej e sigurt në shtëpinë në Vitomiricë të Pejës, por kishte thënë se nuk do të hiqte dorë as nga djali i saj i mitur, as nga pasuria.

Ky rast nxiti edhe formimin e komisionit parlamentar për të hetuar nëse kishte mungesë veprimesh nga institucionet e sigurisë dhe drejtësisë në lidhje me vrasjen e Zekajt, teksa autoritetet i kanë pezulluar 13 zyrtarë që ishin marrë me rastin e saj për dhunë në familje.

Lidhur me rastin është arrestuar ish-kunati i saj, i dyshuari për vrasjen, i cili gjendet në paraburgim, ndërkaq katër të tjerë janë ndaluar.

16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë gjinore

Me Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj grave nis edhe fushata 16 ditët e aktivizmit kundër dhunës me bazë, që përfundon më 10 dhjetor. Kjo fushatë këtë vit përqendrohet në mbajtjen përgjegjës të personave që ushtrojnë dhunë ndaj grave, por edhe për inkurajimin e raportimeve të rasteve.

Në nisje të fushatës kundër dhunës me bazë gjinore në Kosovë, kryeparlamentarja e Kosovës, Albulena Haxhiu, tha se kjo dhunë ka rrënjët te "pabarazia dhe te normat që u kanë rrënjosur bindjen se burrat kanë të drejtë të vendosin për jetën e një gruaje".

Përmes një videoadresimi, Haxhiu u shpreh se përgjegjësia për dhunën është gjithmonë e personit që e ushtron, por përgjegjësia për ta ndaluar është e institucioneve, familjeve dhe shoqërisë.

Ndërkaq, ministrja e Drejtësisë, Donika Gërvalla, u bëri thirrje grave ta raportojnë dhunën ndaj tyre. Ajo tha se luftimi i dhunës kërkon jo vetëm angazhim institucional, por edhe një qëndrim të palëkundur shoqëror.

Ministrja e Drejtësisë tha se nga viti 2019 deri në tetor të këtij viti në Kosovë janë regjistruar 19 916 raste të dhunës në familje dhe gjatë kësaj periudhe janë vrarë edhe 33 gra. "Mos jetoni nën kërcënimin e dhunës, mos heshtni, mos e arsyetoni dhe mos e toleroni", porositi Gërvalla përmes një videoadresimi.

Nisja e fushatës 16 ditë të aktivzimit kundër dhunës me bazë gjinore në Kosovë vjen një ditë pasi Gjykata e Apelit la në fuqi dënimet për vrasjen e Liridona Ademajt, një tjetër gruaje viktimë të femicidit.

Për vrasjen e vitit 2023, bashkëshorti i saj, Naim Murseli, është i dënuar me burgim të përjetshëm, ndërkaq dy persona të tjerë janë dënuar me 30 vjet burgim.

Sipas aktgjykimit të shkallës së parë, Murseli kishte organizuar vrasjen e bashkëshortes së tij, për shkak të raporteve jo të mira martesore, por edhe me qëllim që të përfitonte financiarisht nga një policë e sigurimit të jetës në emër të viktimës, në vlerë prej tre milionë kronash suedeze.

Megjithatë, ka edhe disa raste të tjera të grave të vrara në Kosovë, familjarët e të cilave presin drejtësi.

Dhuna ndaj grave dhe vrasja e tyre është shndërruar në një dukuri shqetësuese në mbarë botën.

Sipas të dhënave të raportit të publikuar një ditë më parë nga Zyra e OKB-së për Drogën dhe Krimin dhe UN Women, më 2025 afër 47 mijë gra dhe vajza u vranë nga partnerët e tyre ose familjarët në mbarë botën. Sipas raportit, shtëpia mbetet vendi më i rrezikshëm për gratë dhe vajzat. Sipas shifrave, 60 për qind u vranë nga partnerët apo familjarët e tyre. Mesatarisht, u tha në raport, çdo ditë 129 gra dhe vajza u vranë nga njerëzit e rrethit të tyre të afërt.

KQZ-ja konfirmon përmbushjen e kushtit ligjor për procedimin e Nismës Legjislative Qytetare të IKD-së

PRISHTINË, 26 NËNTOR - Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) ka bërë me dije se Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka konfirmuar se është përmbushur kushti ligjor prej së paku 10 mijë nënshkrimesh për procedimin e Nismës Legjislative Qytetare të këtij instituti. Përmes një njoftimi, IKD ka theksuar se me këtë konfirmohet vullneti i qytetarëve për ndryshimet në Kodin Penal. "Nisma tashmë i është përcjellë Qeverisë për dhënien e mendimit ligjor. Pas kësaj faze, ajo do të procedohet në Kuvendin e Kosovës për shqyrtim, sipas procedurës parlamentare. Faleminderit të gjithë qytetarëve që e mbështetën këtë nismë!", thuhet në njoftimin e IKD-së.



Çmimet e importit në Kosovë shënojnë rritje prej 5,4-përqindësh

Prishtinë, 25 nëntor - Agjencia e Statistikave e Kosovës (ASK) ka publikuar Indeksin e Çmimeve të Importit për tremujorin e tretë të vitit 2026, sipas të cilit, çmimet e importit në Kosovë kanë shënuar rritje prej 0,8-përqindësh krahasuar me tremujorin e dytë të këtij viti. Sipas të dhënave të ASK-së, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, çmimet e importit kanë shënuar rritje prej 5,4-përqindësh.

Rritja më e madhe e çmimeve në baza tremujore është regjistruar tek artikujt e gurit, llaçit, produktet e qeramikës dhe të qelqit me 5,9 për qind, pasuar nga plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre me 4,6 për qind, produktet minerale me 2,6 për qind, si dhe produktet e industrive kimike me 2,5 për qind.

Rritje është shënuar edhe te pajisjet e makinerisë dhe pajisjet elektrike me 1,3 për qind, si dhe te letra dhe artikujt e saj me 0,8 për qind.

Ndërkaq, rritja e përgjithshme është zbutur nga rënia e çmimeve në disa sektorë, ku veçohet ajo tek instrumentet optike, fotografike, matëse, mjekësore, muzikore dhe mekanizmat e orës me 11,3 për qind. Rënie është shënuar edhe te vajrat ushqyese me 2,7 për qind, lëkura dhe artikujt e saj me 1,1 për qind, mjetet e transportit me 1 për qind dhe druri dhe artikujt e tij me 0,6 për qind.

Në krahasim me tremujorin e tretë të vitit 2025, rritja më e madhe e çmimeve është regjistruar te lëkura dhe artikujt e saj me 34,4 për qind, produktet minerale me 23,6 për qind, plastika, kauçuku dhe artikujt e tyre me 10,7 për qind, si dhe artikujt e gurit, llaçit, produktet e qeramikës dhe të qelqit me 8,2 për qind.

Rritje është evidentuar edhe te artikujt e ndryshëm të prodhuar me 7,3 për qind dhe produktet e industrive kimike me 6,8 për qind.

Në anën tjetër, në bazë vjetore, rënie e çmimeve është regjistruar tek instrumentet optike, fotografike, matëse, mjekësore, muzikore dhe mekanizmat e orës me 7 për qind, produktet bimore me 3,8 për qind, vajrat ushqyese me



1,4 për qind, mjetet e transportit me 0,4 për qind, si dhe metalet bazë dhe artikujt e tyre me 0,1 për qind.

Të dhënat janë publikuar nga Agjencia e Statistikave e Kosovës në kuadër të raportit për Indeksin e Çmimeve të Importit për TM3 2026.

GUVERNATORI ISMAILI NË BQE: FORCIMI I DIALOGUT PËR QËNDRUESHMËRINË EKONOMIKE DHE TË ARDHMEN E PAGESAVE EVROPIANE

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

Prishtinë, 26 nëntor - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, i shoqëruar nga zëvendësguvernatori Dardan Fusha, mori pjesë në Seminarin e Këshillit të Përgjithshëm me bankat qendrore të vendeve kandidate dhe kandidate potenciale për anëtarësim në BE, të mbajtur në Bankën Qendrore Evropiane (BQE) në Frankfurt.

Seminari mblodhi guvernatorët e bankave qendrore për të shkëmbyer pikëpamje mbi zhvillimet ekonomike dhe financiare, efektet e tyre ndërkufitare dhe sfidat e përbashkëta të bankave qendrore.

Gjatë diskutimit për lidhjet ekonomike dhe financiare me BE-në dhe eurozonën, guvernatori Ismaili vuri në pah lidhjet e ngushta ekonomike të Kosovës me BE-në dhe qëndrueshmërinë e sistemit të saj financiar. Ai theksoi se për Kosovën, si ekonomi e vogël, e hapur dhe plotësisht e euroizuar, euroja shërben si një spirancë e fortë nominale, ndërsa zhvillimet ekonomike dhe financiare në eurozonë mund të përcillen me shpejtësi në ekonominë vendore.

"Për Kosovën, integrimi më i thellë me BE-në është një rrugë drejt konvergjencës dhe një burim qëndrueshmërie, konkurrence dhe prosperiteti afatgjatë", tha guvernatori Ismaili.

Guvernatori Ismaili mori pjesë gjithashtu në një diskutim me anëtarin e Bordit Ekzekutiv të BQE-së, Piero Cipollone, dhe guvernatorët e bankave qendrore pjesëmarrëse mbi zhvillimet në pagesat evropiane.

Diskutimi përfshiu pagesat e shpejta, Zonën e Vetme të Pagesave në Euro (SEPA), euron digjitale dhe zhvillimet lidhur me paranë e bankës qendrore për transaksione me shumicë.

Guvernatori Ismaili paraqiti përparimin e Kosovës drejt përfshirjes në SEPA, duke përmendur aplikimin zyrtar të dorëzuar në Këshillin Evropian të Pagesave më 6 nëntor 2026. Ai theksoi rëndësinë e pagesave ndërkufitare në euro më të shpejta, më të sigurta dhe më të përballueshme për qytetarët dhe bizneset e Kosovës.

Gjithashtu, ai vuri në pah fillimin e funksionimit të Sistemit të Pagesave të Shpejta të Kosovës (TIPS-K), i cili përdor platformën TIPS Clone, të zhvilluar dhe të operuar nga Banka e Italisë (Banca d'Italia), si një hap në modernizimin e infrastrukturës së pagesave në Kosovë.

Guvernatori theksoi se për Kosovën, si ekonomi e euroizuar, është me rëndësi t'i ndjekë zhvillimet lidhur me euron digjitale dhe të mbajë dialog të afërt teknik me homologët evropianë mbi zhvillimet në fushën e pagesave në Evropë.

BQK-ja do ta vazhdojë bashkëpunimin dhe dialogun profesional me bankat qendrore dhe institucionet evropiane për ta mbështetur stabilitetin financiar, për ta modernizuar infrastrukturën financiare të Kosovës dhe për të harmonizuar më tej sektorin e saj financiar me standardet përkatëse evropiane.



KOMPANIA FRANCEZE AKUO ENERGY SAS SHPALLET FITUESE E ANKANDIT TË PARË TË ENERGJISË NGA ERA ME KAPACITET PREJ 98 MW

Prishtinë, 26 nëntor - Ministria e Ekonomisë ka njoftuar se ka përmbyllur me sukses ankandin e parë të energjisë nga era në Republikën e Kosovës, duke shpallur fituese kompaninë franceze AKUO Energy SAS, me kapacitet të ofruar prej 98 MW dhe me çmim prej 75.94 eurosh për megavatorë (MWh).

Çmimi fitues është 5.31 % më i ulët se çmimi tavan prej 80.20 euro/MWh, i përcaktuar nga Zyra e Rregullatorit për Energji.

Në fazën e parë të këtij ankandi ishin kualifikuar tri kompani dhe konsorciume nga Franca, Turqia, Gjermania dhe Kosova.



Pas përfundimit të vlerësimit të ofertave teknike dhe financiare, si dhe kalimit të afatit për ankesa, gjatë të cilit nuk është pranuar asnjë ankesë, kompania AKUO Energy SAS është shpallur zyrtarisht fituese e ankandit, me çmimin më të ulët të ofruar.

Sipas Ministrisë së Ekonomisë, realizimi i këtij projekti pritet të sjellë një investim prej rreth 150 milionë eurosh në sektorin e energjisë në Kosovë, duke shtuar kapacitetet vendore të prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme, duke kontribuar në uljen e varësisë nga importi i energjisë elektrike, rritjen e sigurisë së furnizimit dhe krijimin e vendeve të reja të punës.

"Pas suksesit të ankandit të parë solar prej 100 MW, përmbyllja e suksesshme e ankandit të parë të erës shënon një tjetër hap të rëndësishëm në realizimin e objektivave të Strategjisë së Energjisë 2022-2031 dhe dëshmon interesimin e investitorëve ndërkombëtarë për investime në sektorin e energjisë në Kosovë", ka njoftuar kjo ministri.

Hapi i radhës në këtë proces është nënshkrimi i marrëveshjeve të projektit të cilat do t'i përcaktojnë të drejtat dhe obligimet e palëve për realizimin e këtij investimi.

Ankandi i parë i energjisë nga era është zhvilluar me mbështetjen e Korporatës Ndërkombëtare Financiare (IFC), pjesë e Grupit të Bankës Botërore dhe me mbështetjen e Qeverisë së Luksemburgut përmes LuxDev - Luxembourg Development Cooperation Agency.

Ministria e Ekonomisë ka theksuar se mbetet e përkushtuar në zhvillimin e kapaciteteve të reja energjetike përmes proceseve konkurruese dhe transparente, duke siguruar çmime konkurruese të energjisë, tërheqjen e investimeve private dhe një të ardhme energjetike më të sigurt dhe më të pastër për qytetarët e Kosovës.

ERË LUFTE - BRITANIA PËRGATITET PËR NJË KONFLIKT TË MUNDSHËM ME RUSINË



Britania e Madhe po ndërmerr hapa për të rritur gatishmërinë e saj ushtarake, në një kohë kur shqetësimet për kërcënimin rus dhe mundësinë e përshkallëzimit të konfliktit në Evropë po shtohen.

Ministria britanike e Mbrojtjes u ka dërguar letra rreth 100 mijë ish-ushtarakëve, duke u kërkuar të përditësojnë të dhënat personale dhe të japin informacion mbi aktivitetin e tyre aktual profesional dhe aftësitë e fituara pas largimit nga Forcat e Armatosura.

Sipas gazetës britanike "The Telegraph", kjo nismë po zbatohet për herë të parë që nga Lufta e Ftohtë në një shkallë të tillë dhe synon forcimin e të ashtuquajturës "rezervë strategjike" të vendit.

Letrat, të cilat mbajnë firmat e drejtuesve të tri degëve të Forcave të Armatosura, u drejtohen ish-ushtarakëve që vazhdojnë të jenë pjesë e rezervës ushtarake. Ata kanë gjithashtu mundësinë të shprehin vullnetarisht gatishmërinë për të marrë pjesë në ushtrime dhe aktivitete stërvitore.

Megjithatë, Ministria e Mbrojtjes ka sqaruar se kjo nismë nuk përbën një urdhër mobilizimi dhe as nuk nënkupton se rikthimi i menjëhershëm i rezervistëve në shërbim është i afërt. Bëhet fjalë për një masë organizative, që synon të krijojë një pasqyrë të qartë të personelit të disponueshëm dhe të mundësojë mobilizimin e shpejtë të tij në rast emergjence.

Plani britanik parashikon edhe ushtrime të gjera për të testuar aftësinë e Forcave të Armatosura për të thirrur ish-ushtarakët, për t'i pajisur dhe për t'u caktuar detyra konkrete në rast lufte ose krize të rëndë sigurie.

Një prej aktiviteteve ku parashikohet përfshirja e rezervës strategjike është stërvitja e NATO-s "Steadfast Defender", e planifikuar për pranverën e vitit 2027. Sipas informacioneve të paraqitura më herët nga qeveria britanike në Parlament, deri në 1,000 pjesëtarë të rezervës strategjike pritet të ftohen për të marrë pjesë në këtë stërvitje, së bashku me ushtarakët aktivë dhe rezervistët e tjerë.

Ndërkohë, në janar të vitit 2026, Ministria e Mbrojtjes njoftoi ndryshime ligjore që synojnë zgjerimin e grupit të ish-ushtarakëve që mund të rikthehen në shërbim.

Një prej ndryshimeve kryesore është rritja e kufirit maksimal të moshës për rikthim nga 55 në 65 vjeç. Gjithashtu, parashikohet harmonizimi i rregullave për detyrimin e rikthimit në shërbim mes tri degëve të Forcave të Armatosura.


Ndryshimet janë përfshirë në Projektligjin e Forcave të Armatosura 2026, i cili synon t'i japë qeverisë më shumë fleksibilitet për aktivizimin e rezervistëve, përfshirë edhe në kuadër të përgatitjeve për operacione ushtarake.

Rritja e gatishmërisë ushtarake britanike vjen në një periudhë tensionesh të shtuara në Evropë, ku lufta në Ukrainë dhe kërcënimi i një përballjeje më të gjerë me Rusinë kanë rikthyer në vëmendje nevojën për mobilizimin e shpejtë të forcave ushtarake.

Shqetësimet janë shtuar edhe pas incidenteve të fundit me raketa dhe dronë rusë pranë territorit polak, në një kohë kur në rajon po zhvilloheshin stërvitje ushtarake të drejtuara nga Britania.

Përmes këtyre masave, Londra synon të sigurojë që, në rast të një krize të rëndë apo konflikti të mundshëm, të ketë në dispozicion jo vetëm trupat aktive, por edhe një numër të konsiderueshëm ish-ushtarakësh me përvojë, të cilët mund të rikthehen në shërbim brenda një kohe të shkurtër.

ERË LUFTE - BRITANIA PËRGATITET PËR NJË KONFLIKT TË MUNDSHËM ME RUSINË



Ndërsa bota po përpiqet të përballojë rreziqet që burojnë nga inteligjenca artificiale, një tjetër revolucion teknologjik kërcënon të përmbysë sistemet mbi të cilat mbështetet siguria e internetit: informatika kuantike.

Kompjuterët kuantikë të së ardhmes mund të bëhen aq të fuqishëm sa të thyejnë disa prej metodave aktuale të enkriptimit, duke vënë në rrezik komunikimet private, transaksionet bankare, sekretet shtetërore dhe të dhënat e institucioneve publike.

Përballë këtij skenari, Bashkimi Evropian po përgatitet të ndërmarrë masa për mbrojtjen e infrastrukturës së tij dixhitale. Sipas një projektligji të siguruar nga revista "Politico", Brukseli synon të përshpejtojë përgatitjet përmes "Aktit të Teknologjisë Kuantike", duke nxitur kalimin drejt sistemeve të reja të sigurisë.

Shqetësimi kryesor është se kompjuterët kuantikë, kur të arrijnë kapacitetin e nevojshëm, mund të deshifrojnë informacione që sot konsiderohen të mbrojtura. Kjo do të ekspozonte një gamë të gjerë institucionesh, nga bankat dhe spitalet deri te agjencitë e inteligjencës dhe strukturat ushtarake.

"Kur bëhet fjalë për teknologjinë kuantike, ne e dimë se ajo paraqet rreziqe, sepse është e aftë të anashkalojë masat aktuale të sigurisë që kemi për të dhënat tona. Por, në të njëjtën kohë, teknologjia kuantike ofron gjithashtu mundësi për komunikime më të sigurta", deklaroi Henna Virkkunen, zëvendëspresidente ekzekutive e Komisionit Evropian për sovranitetin teknologjik.

Strategjia e Brukselit mbështetet në një parim të ngjashëm me atë që po ndiqet për inteligjencën artificiale: teknologjia duhet të vihet në dispozicion të mbrojtjes përpara se të shfrytëzohet nga sulmuesit.

BE-ja synon gjithashtu të mbështesë kompanitë evropiane që zhvillojnë teknologjinë kuantike, duke reduktuar varësinë nga furnizuesit e huaj në një sektor që konsiderohet strategjik për sigurinë kombëtare.

Sa kohë ka mbetur për t'u përgatitur?

Gjiganti teknologjik IBM synon të ketë gati kompjuterin e tij të parë kuantik në shkallë të gjerë deri në vitin 2029. Ekspertët paralajmërojnë se në vitet pasuese mund të shfaqen pajisje me kapacitetin e nevojshëm për të thyer disa nga standardet aktuale të enkriptimit.

Théau Peronnin, drejtues i kompanisë franceze të teknologjisë kuantike "Alice & Bob", vlerëson se një moment i tillë mund të mbërrijë në vitin 2032.

"Jemi në një situatë ku kemi ende kohë, por duhet të reagojmë shpejt", deklaroi ai.

Ndryshe nga kompjuterët tradicionalë, të cilët përpunojnë informacionin përmes biteve me vlerë 0 ose 1, kompjuterët kuantikë përdorin kubitët, të cilët mund të ekzistojnë në një kombinim të këtyre dy gjendjeve deri në momentin e matjes.

Kjo veçori, së bashku me fenomene të tjera kuantike, u mundëson atyre të zgjidhin disa kategori problemesh matematikore shumë më shpejt se kompjuterët klasikë.

Një prej shqetësimeve më të mëdha është se aktorët keqdashës mund të grumbullojnë që sot informacione të enkriptuara, për t'i deshifruar ato në të ardhmen, kur teknologjia kuantike të ketë arritur nivelin e nevojshëm.

Një garë e re mes fuqive botërore

Komisioni Evropian ka hartuar më herët një plan për mbrojtjen e infrastrukturës kritike përmes kriptografisë post-kuantike deri në fund të vitit 2030.

Paralelisht, vendet anëtare të BE-së, Komisioni Evropian dhe Agjencia Evropiane e Hapësirës po punojnë për ndërtimin e një infrastrukture të sigurt komunikimi kuantik, të njohur si EuroQCI.

Edhe Shtetet e Bashkuara po përshpejtojnë përgatitjet për kalimin drejt standardeve të reja të enkriptimit, ndërsa teknologjia kuantike po shndërrohet gjithnjë e më shumë në një fushë të konkurrencës gjeopolitike.

"Në klimën aktuale gjeopolitike, do të ishte naive të pretendonim se jemi pionierë në teknologji të caktuara, por të mos i përdornim ato për të mbrojtur veten", deklaroi Jan Goetz, drejtues i kompanisë finlandeze IQM.

Nëse inteligjenca artificiale ka ndryshuar mënyrën se si zhvillohen sulmet kibernetike, kompjuterët kuantikë mund të ndryshojnë vetë themelet e sigurisë dixhitale. Gara e radhës teknologjike nuk do të zhvillohet vetëm për fuqinë kompjuterike, por edhe për aftësinë e shteteve për të mbrojtur sekretet e tyre.



sport

QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Nesër nuk luhet asnjë ndeshje e Superligës së Kosovës



PRISHTINË, 26 NËNTOR - Superliga e Kosovës në futboll do ta vazhdojë xhiron e rregullt, ndeshjet e së cilës nuk do të zhvillohen nesër (e shtunë). Arsyeja kryesore pse nuk do të ketë ndeshje nesër është festa e 28 Nëntorit. Duelet e parapara për t'u zhvilluar në këtë ditë janë zhvendosur për të hënën. Pra, duelet e xhiros së 15 në elitën e futbollit të Kosovës do të zhvillohen të premten, të dielën dhe të hënën.

Xhiroja hapet sot (e premte) me përballjen Malisheva - Llapi, për të vazhduar të dielën me ndeshjet Gjilani - Drita dhe Feronikeli '74 - Prishtina.

Ndërkohë të hënën do të zhvillohen duelet Drenica - Vushtrria dhe Dukagjini - Ballkani. Të gjitha përballjet nisin nga ora 13:00, me përjashtim të ndeshjes në Gjilan, e cila fillon në orën 16:00.

MURIQI HERO I FENERBAHÇES NDAJ SHAKHTARIT, ÇMIMIN 'LOJTARI I NDESHJES' IA DEDIKON GRUAS

LONDËR, 26 NËNTOR - Vedat Muriqi ka qenë protagonist i madh në fitoren e Fenerbahçes ndaj Shakhtar Donetskut në Ligën e Kampionëve. Sulmuesi i Kosovës ka realizuar golin e vetëm të takimit, duke ia siguruar skuadrës turke tri pikë shumë të rëndësishme, ndërsa pas ndeshjes është shpërblyer edhe me çmimin "Lojtari i Ndeshjes". Pas përfundimit të sfidës, Muriqi nuk e ka fshehur kënaqësinë për triumfin, duke theksuar rëndësinë e madhe të pikëve të fituara. Ai ka falënderuar edhe tifozët për përkrahjen e jashtëzakonshme, duke thënë se atmosfera në stadiumin "Stamford Bridge" ishte sikur të luanin në shtëpi, në Kadikoy. Muriqi ka folur edhe për barazimin e fundit ndaj Kocaelisporit dhe



mesazhin që trajneri Emre Belozoglu ua kishte dhënë futbollistëve: "Mbajeni kokën lart, do të bëhemi më të mirë". Ai ka shtuar se skuadra ka punuar për një kohë të shkurtër me trajnerin e ri dhe se duhet të vazhdojë të punojë për t'u përmirësuar.

Momenti më i veçantë i deklaratave të tij ka qenë dedikimi i çmimit për bashkëshorten. "Ajo nuk merr shumë vesh nga futbolli, por që kur u kualifikuam në Ligën e Kampionëve, më pyeste se për çfarë shërben ky çmim. Kur i tregova se i jepet lojtarit më të mirë të ndeshjes, më tha se e dëshironte edhe ajo një të tillë. E dashura ime, kjo është për ty. Po e marr këtë çmim në shtëpi me gjithë zemër", ka përfunduar Muriqi.

E ARDHMJA E ZVICRËS APO KOSOVËS? LEART KABASHI, SHQIPTARI QË PO MAHNIT SKOCINË

EDINBURG, 26 NËNTOR - Ndonjëherë duhet ndryshuar ambienti për të treguar se çfarë je në gjendje të bësh. Kjo vlen edhe për futbollistin shqiptar me shtetësi zvicerane, Leart Kabashi. 18-vjeçari u transferua verën e kaluar nga Grasshoppers në Skoci, te Hearts, dhe pas vetëm disa ndeshjesh ka filluar të flitet shumë për të.

Në fakt, Kabashi kishte arritur ta tërhiqte vëmendjen edhe në Cyrih. Në debutimin e tij, në moshën 17-vjeçare, ai arriti të shënonte menjëherë gol. Megjithatë, pas ndryshimit të



drejtimit të klubit, ai u rikthye te skuadra U21, ku vazhdoi të bindte me paraqitje të mira. Për këtë arsye, gjatë verës Kabashi vendosi të largohej dhe u transferua te Heart of Midlothian. Nënkampioni i Skocisë aktualisht luan në Ligën e Konferencës. Në Edinburg, Kabashi duket se po merr besimin që nuk iu dha në Zvicër. Pas paraqitjes së tij të parë, ai u shpall lojtari i ndeshjes. Edhe në paraqitjen e dytë, kundër Dundeet (fitorja 8:0), futbollisti shqiptar shkëlqeu, madje në një pozitë të pazakontë për të.

Në vend që të luante në repartin sulmues, siç bën zakonisht, 18-vjeçari u aktivizua në mesfushën defensive dhe e mahniti trajnerin e tij, Wouter Vrancken. "Ai është shumë i mirë dhe shumë inteligjent", ka deklaruar trajneri. Sipas tij, Kabashi është "i shkëlqyer mes linjave" dhe ka aftësinë ta organizojë lojën. "Ai e ka dëshmuar në stërvitje se mund ta përmbushë këtë rol", ka shtuar Vrancken.

Ndërsa vetë futbollisti i ri shqiptar, lidhur me këtë pozitë të pazakontë, është shprehur shkurt: "Unë luaj aty ku më vendos trajneri". Së fundmi, Kabashi është ftuar edhe në Kombëtaren U20 të Zvicrës nga trajneri Alex Frei. Në ndeshjen kundër Rumanisë ai ka luajtur 45 minuta, ndërsa në përballjen me Italinë ka qëndruar në fushë për 65 minuta. Se sa mirë po i ecën në Skoci, dëshmon edhe reagimi i medieve. Pas fitores 8:0, gazeta britanike "Daily Record" ka vlerësuar se Kabashi ka një të ardhme të jashtëzakonshme përpara. "Ai luan me shumë qetësi dhe pjekuri, ndërsa duket se mund të përshtatet në disa pozita të ndryshme", ka shkruar gazeta britanike.

Ende nuk dihet se në cilën pozitë do të luajë të dielën. Ndeshja kundër Celticut do të jetë sfida e parë e madhe për Kabashin në Skoci. Në të njëjtën ditë, ai do ta festojë edhe ditëlindjen e tij të 19.

PEREZI PLANIFIKON REVOLUCIONIN HISTORIK TE REALI, KLUBI VLERËSOHET NË 10 MILIARDË EURO

MADRID, 26 NËNTOR - Florentino Perez po përgatit një ndryshim të madh në strukturën ekonomike të Real Madridit përmes krijimit të një kompanie të re tregtare, vlera e së cilës parashikohet të arrijë rreth 10 miliardë euro. Presidenti madrilen synon t'ua hapë derën investitorëve të jashtëm, por pa ia dorëzuar kontrollin e klubit askujt tjetër. Sipas planit të



raportuar nga mediet spanjolle, Real Madridi do të mbajë nga 80 deri në 90 për qind të aksioneve të kompanisë së re, ndërsa pjesa e mbetur do t'u ofrohet investitorëve. Fillimisht është miratuar mundësia e shitjes së pesë për qind të aksioneve, që do t'i sillte të paktën 500 milionë euro në arkat e klubit. Për një pjesëmarrje prej 10-përqindësh, investimi do të arrinte në një miliard euro. Megjithatë, Perezi këmbëngul se ky ndryshim nuk do ta nënkuptojë privatizimin e Real Madridit. Ai dëshiron që klubi të vazhdojë të jetë në duart e anëtarëve të tij, të cilët do ta kenë fjalën përfundimtare për të ardhmen e institucionit. "Fatin e Real Madridit do ta vendosin vetëm anëtarët. Kështu ka qenë gjithmonë dhe kështu do të jetë", ka deklaruar Perezi.

Projekti duhet të marrë fillimisht miratimin e Asamblesë së Përgjithshme dhe më pas të kalojë në referendum te anëtarët e klubit. Nëse realizohet, kjo do të përbënte një nga ndryshimet më të mëdha në historinë ekonomike të Real Madridit, duke i hapur rrugë një modeli të ri financiar, pa hequr dorë nga pronësia e anëtarëve.

Rey Manaj kërkohet në Serinë A



TIRANË, 26 NËNTOR - Skuadra e Lecces ka shprehur menjëherë interesim për sulmuesin shqiptar, Rey Manaj. Manaj këto ditë është larguar zyrtarisht nga Sivasspori, një largim i befasishëm, por që ka ndodhur për shkak të mospagesave. Sulmuesi "kuqezi", i cili tashmë është lojtar i lirë, është gati për një aventurë të re. Siç raportohet, skuadra italiane në Serinë A, Lecce, ka shprehur interesim për sulmuesin shqiptar. Manaj do të dëshironte një kalim të tillë dhe e njeh shumë mirë Serinë A, pasi në të kaluarën ka luajtur për Interin, Pisan dhe Pescaran.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "KOMPANIA EXX" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. Unik Identifikues: 810842428 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "KOMPANIA EXX" D.O.O. sa sjedištem u Pristina, donelo odluku o prestani rada sa NUI: 810842428 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "KOMPANIA EXX" L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business NUI: 810842428 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM


Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar "Kopshti i Fëmijve Yjet" SH.P.K. me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nr. Unik Identifikues: 811881227 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa "Kopshti i Fëmijve Yjet" D.O.O. sa sjedištem u Pristina, donelo odluku o prestani rada sa NUI: 811881227 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability "Kopshti i Fëmijve Yjet" L.L.C. with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business NUI: 811881227 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Zvogëlim i kapitalit nga firma EUROFAMIS Sh.A

Firma "EUROFAMIS" Sh.A, me numër UNIK IDENTIFIKUES, NUI: 811306431, me seli në Shirokë, Suharekë, bën zvogëlimin e kapitalit nga vlera 910.000,00 euro në vlerën 10.000,00 euro.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- DENIS JUSUFI shpalle te pavleshme diplomen dhe deftesat e vitit I ,II,III te SHMLT ARKITEKT SINANI

- Shaban Kryeziu shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Driton Bucaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Abdyl Frasheri " Prizren.

- Armend Hoxhaj shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën Q K "11 Marsi " Prizren.

- Trim Rezniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl.10 të sh.m.p "Gjon N. Kazazi" Gjakovë.

- Sokol Haxhikadrija shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 33049408.

- Elidon Pylla B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 811149542 të lëshuar nga ARBK.

- Genti Kurhasku shpall të pavlefshme certifikatën e maturës shtetërore të sh.m. mjekësisë "Hysni Zajmi" Gjakovë.


100%
Fresh &
Natural
VIDAS
Llatte
drink
2%
TAMËL
PRODHUAR ME
FINESË DHE DASHURI
2,8%
Schmand
ajkë e freskët
sour cream
18% yndyrë
800g
JOGURT
DHALLË
ROYAL CROWN
RC
cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L


MEKA
HALAL FOOD
TRADITË QË NGA
1992
MEKA
HALAL FOOD
PASHTETË
PULE
GLUTEN FREE
100% MISH PULE
CILËSI E GARANTUAR
PA KONSERVUES